




OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

**Raport studimor
“Buxheti për fëmijë” për vitin 2012 - Qarku Kukës**



QARKU KUKËS

Eksperti Rajonal
Shkëlqim Muça
Prill 2014

LISTA E SHKURTIMEVE

INSTAT	– Instituti i Statistikave
SHSSH	- Shërbimi social shtetëror
Df	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
NJDF	- Njësia për të Drejtat e fëmijëve
DSHP	- Drejtoria e Shëndetit Publik
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
GDP	- Prodhimi i brendshëm bruto
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
CFPU	- Njësia për mbrojtjen e fëmijës dhe familjes
NJDF	- Njësia për te drejtat e fëmijëve
MPCSSHB	- Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Hyrje dhe falënderime

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve është një iniciativë e UNICEF e cila ka ngritur mekanizmin për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni. Observatori për të drejtat e fëmijëve është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Kukësit në vitin 2008, e cila në bashkëpunim me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë realizon mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

Observatori për të drejtat e fëmijëve ka bashkëpunuar në nivel qarku me të gjitha njësitë vendore, administratorët social në bashki/komuna, institucionet arsimore dhe shëndetësore, njësitë për të drejtat e fëmijëve në bashki/komuna, Njësinë për të Drejtat e Fëmijëve në këshillin e qarkut dhe organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Që nga fillimi i punës së tij observatori për të drejtat e fëmijëve ka bërë të mundur sensibilizimin e të gjithë aktorëve në qark që të luajnë një rol më aktiv në promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Observatori ka bërë analizë periodike të të dhënave të grumbulluara si dhe ka vlerësuar situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel lokal dhe rajonal. Nëpërmjet punës së observatorit, duke pasur si detyrë të tij mirëmbajtjen dhe rifreskimin e bazës së të dhënave, shoqëria civile ka identifikuar problemet më kritike që cenojnë realizimin e të drejtave të fëmijëve. E gjithë kjo përpjekje e Observatorit për të drejtat e fëmijëve është realizuar falë bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe shëndetësore, organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, punë e cila është arritur falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që punojnë me fëmijët.

Mirënjohje e veçantë për bashkëpunimin me Observatorin Kukës shkon për përfaqësuesit e administratës publike lokale dhe personave të kontaktit në Zyren Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore Has dhe Tropojë, Zyrën e Statistikave qarkut Kukës, Njësinë për të drejtat e fëmijëve në Qarkun Kukës, njësite për të drejtat e fëmijëve në bashki dhe komuna.

Për hartimin e këtij raporti studimor në lidhje me “Buxhetimin për fëmijët”, falënderojmë administratorët sociale në bashkitë dhe komunat e qarkut si dhe degen e thesarit Kukës, për bashkëpunimin.

Një falënderim shkon për stafin drejtues të projektit Observatori për të Drejtat e Fëmijëve znj. Elma Tërshana (Drejtoreshë ekzekutive Observatorit), Znj. Mina Mata (Administratore Kombëtare për të dhënat), Znj. Ermira Zace (Administratore dhe Financiere) për mirëkuptimin dhe mbështetjen për realizimin e këtij studimi.

Hyrje

Realizimi i studimit “**Buxhetimi për fëmijë**”, synon të analizojë përmes llogaritjeve të shpenzimeve publike që shkojnë për fëmijet situatën social-ekonomike dhe ka si qëllim final përmiresimin e nivelit të jetesës të popullsisë, pa bërë dallime, apo pa u diferencuar për shtresa të ndryshme të saj.

Analiza e studimit përfshin të dhëna dhe informacione që i përkasin vitit 2012. Ky studim do të ofrojë gjithashtu dhe: analizën e gjendjes së përgjithshme të të drejtave të fëmijëve në rajon duke u fokusuar tek gjendja e tyre social – ekonomike, informacion të thelluar për grupet e fëmijëve në nevojë, aksesin në shërbime si dhe rekomandime për të ardhmen. Ky raport, synon që tu vijë në ndihmë dhe t’ju shërbejë të gjitha njësive vendore, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, njësive për të drejtat e fëmijëve në bashki/komuna, organizatave joqeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut Kukës; Në mënyrë të veçantë, ky studim ndihmon të gjitha njësitë vendore që të jene më të vëmendeshme në planifikimin e buxhetit për tu ardhur me mire në ndihmë nevojanve që kanë fëmijet në territorin që ato mbulojnë.

Metodologjia e ndjekur për hartimin e këtij raporti, informacioni i mbeldhur nga Zyra Rajonale e SHSSH Kukës, DAR, Drejtoria Statistike Kukes, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Dega e thesarit Kukes.

Janë shqyrtuar gjithashtu dhe materiale e studime kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë pasur në fokus buxhetimin për fëmijet dhe politikat sociale si:

- Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri (2006), Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore,
- Programi buxhetor “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe ai profesional”,
- Programi buxhetor “Shërbimet e kujdesit parësor”, “Shërbimet e kujdesit publik”.
- Program buxhetor i MPCSShB “Mbrojtja sociale”, “Shanset e barabarta”.
- Projekt buxheti PBA 2011- 2013, Ministria e Financës, Drejtoria e përgjithshme e buxhetit.
- Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri Unicef.
- Relacion mbi buxhetin faktik 2011, Ministria e Financave, Drejtoria e përgjithshme e buxhetit.

1. Përshkrim i përgjithshëm i situatës së të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku

Qarku i Kukësit shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe ka në përbërjen e tij 27 njësi vendore, nga të cilat 24 komuna dhe 3 bashki. Qendra administrative, politike, ekonomike dhe kulturore e qarkut është qyteti i Kukësit. Popullsia e qarkut Kukës në fund të vitit 2012 ishte 107.911 banorë, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes civile; Ndërsa sipas shërbimit Social Shtetëror Kukës, qarku Kukës numëron 26,461 familje, nga të cilat 12,555 trajtohen me ndihmë ekonomike ose 47,44 %. Vlera totale në lekë që këto familje kanë përfituar gjatë vitit 2012 është 578.811.400 lekë, në formën e ndihmës ekonomike)¹.

Në qarkun e Kukësit mbizotërojnë moshat e reja. Fëmijët e moshës 0-18 vjeç përbëjnë 31.43 % të popullsisë së përgjithshme të qarkut (33.922) fëmije për vitin 2012.

Pjesa më e madhe e fëmijëve të qarkut u përkasin familjeve me ndihmë ekonomike ku në këto familje jetojnë 27.621² fëmije ose 81.42% e tyre trajtohen me ndihme ekonomike.

¹ Zyra Rajonale SHSSH Kukes Dhjetor 2013

² Zyra Rajonale SHSSH Kukes Dhjetor 2013

Një fakt që evidentohet nga punonjësit e njësive vendore të Qarkut Kukës, është se familjet të cilat janë vlerësuar për tu trajtuar me **ndihmë ekonomike të plotë janë të privuar** nga përfitimi 100% i kësaj ndihme. Kjo ndodh për shkak të krizës financiare në vend, pasi fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit nuk vjen i plotë pranë SHSSH-së, duke e bërë Institucionin që të bëjë një ndarje pak a shumë të barabartë mes bashkive dhe komunave. Per vitin 2012 fondi i dhene per familjet me ndihme ne qarkun kukes ishte 579.811.400 leke ndersa per personat me aftesi te kufizuar 443.077.960 leke.

Në rajonin e Kukësit numërohen 1,585 fëmijë jetim nga të cilët 47 jetimë biologjik, kurse 1538 jetimë me një prind, prej të cilëve 872 në rrethin e Kukësit, 290 në Tropojë dhe 376 në Has.

Fëmijët jetim përbejnë 3,9 % të fëmijëve të grupmoshës 0-14 vjeç, prej të cilëve 0,01 % janë jetimë biologjik dhe 3,8 % janë fëmijë jetimë me një prind. Pjesa më e madhe e kësaj kategorie jeton në një varfëri ekstreme, pasi këta fëmijë mbahen nga të afërmit e tyre dhe duke qenë familje vete në nevojë e kanë të pamundur të plotësojnë nevojat e këtyre fëmijëve.

Bazuar në një vlerësim për matjen e nivelit të Jetesës (2005, 2008) nga INSTAT³, si dhe në studime dhe analiza të tjera të realizuara gjatë këtyre viteve, - kanë treguar se administrimi i programit të ndihmës ekonomike përballet me vështirësi të cilat ndikojnë në uljen e efektivitetit të tij. Në mënyrë të ngjashme, sistemi ekzistues i ndihmës ekonomike mund të sigurojë të ardhurat e nevojshme për të varfrit, por ai nuk i ndihmon të varfrit që të shpëtojnë nga varfëria.

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë me të rrezikuarit nga përjashtimi social. Ata vuajnë disavantazhe të shumëfishta sociale, sepse kane mundësi te kufizuara në sigurimin e strehimit, arsimit cilësor, kujdesit të përshtatshmen shëndetësor pjesëmarrje shoqërore dhe mbrojtje Po tu referohemi shifrave në qarkun e Kukësit për katër vitet e fundit (2009 - 2012), numri i familjeve që trajtohen nga skema e ndihmës ekonomike ka ardhur në rritje.

Përtej varfërisë së drejtpërdrejtë ekonomike, përjashtimi i tyre shoqëror bën që të drejtat e tyre themelore të kërcënohen nga pasiviteti i detyruar, paaftësia për të arritur potencialin e tyre të plotë dhe për të ndërtuar marrëdhënie njerëzore që mund t'i udhëheqin drejt pjesëmarrjes aktive qytetare.

Shërbimet sociale kryesisht janë të përqendruara në bashkinë Kukës. Ndërsa në njësitë e tjera vendore të Qarkut Kukës nuk ka shërbime të tilla me përjashtim të një zyre shërbimesh (personi kontakti). Në bashkinë Bajram Curri ndodhet zyra/ personi për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjen, pavarësisht se pretendohet që ajo luan rolin e njësisë për mbrojtjen e fëmijëve ne Bajram Curri. Duke mos pasur një shpërndaje të shërbimeve dhe mungesa të një qendre ditore për fëmijët në nevojë, në bashkinë Krumë dh Bajram Curri, kemi:

- një rritjen të rrezikut shoqëror për përjashtim social për grupet e marginalizuar,
- detyrohen fëmijët nga prindërit për të punuar,
- pamundësi e fëmijëve për t'u angazhuar në aktivitete rekreative.

Të drejtat e fëmijëve në vëmendjen lokale

Kuadri aktual ligjor ka krijuar hapësira të mjaftueshme për të hartuar politika rajonale dhe plane të ndryshme veprimi. Kështu si ligji Nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore ” ashtu dhe ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për

³ INSTAT: LSMS 2005.2008

ndihmën dhe shërbimet shoqërore” krijojnë hapësirat e nevojshme për të ndërtuar politika me efikase lokale për fëmijët, i ndryshuar në ligjin nr 10 399 datë 17.03.2011.

Po kështu edhe Miratimi i Ligjit Nr 10347 ka krijuar edhe bazën e plotë ligjore për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave përkatës për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve. Megjithatë në Kukës me mbështetjen e UNICEF janë pilotuar si NJFM ashtu edhe NJDF para se të dilte ky ligj. Gjithashtu është fuqizuar NJDF dhe janë organizuar një sere trajnimesh për te rritur kapacitet e administratoreve social për të identifikuar dhe referuar rastet e fëmijëve në rrezik.

Gjatë vitit 2012 në zbatim të ligjit 10 347 datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” jo të gjitha njësitë vendore të qarkut kukes kanë ngritur Njësitë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve edhe pse ligji e ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e pushtetit lokal për ngritjen dhe funksionimin e këtyre zyrave.

Në qarkun Kukës, NJMF – jane krijuar në 12 njësitë vendore:

- Bashkia Kukës
- Bashkia Krumë
- Komuna B.Currë
- Komuna Terthore
- Komuna Bicaj
- Komuna Golaj
- Komuna Gjinaj
- Komuna Margegaj
- Komuna Bujan
- Komuna Fierzë
- Komuna Tropojë
- Komuna Shtiqen

Këto mekanizma të ngritura me iniciativën e bashkive/ komunave, zënë 44% të njërive vendore në nivel rajonal. Në të ardhmen synohet që të rritet numri i tyre deri në mbulimin e plotë të Qarkut Kukës. Ato bashkëpunojnë edhe me institucionet e tjera publike si edhe me aktorët e shoqërisë civile me fokusin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

Aksesi ndaj buxhetimit

Republika e Shqipërisë pas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, ka ndërmarrë shumë nisma për realizimin e reformave gjithëpërfshirëse me synimin e përforcimit të mirëqenies dhe interesit më të lartë të fëmijës. Qeveria në çdo fundvit harton dhe miraton buxhetin për vitin pasardhës, i cili është i specifikuar në zëra të veçantë. Përlllogaritja e buxhetit që shkon për fëmijët është kompleks dhe realizohet në saj të formulave të gatshme, të koeficienteve duke u bazuar në Institucionet qendrore dhe programe buxhetore përkatëse:

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës me programet buxhetore “Arsimi Bazë” dhe “Arsimi i Mesëm i përgjithshëm dhe profesional”;
- Ministria e Shëndetësisë, me programet buxhetore ”Shërbimet e kujdesit parësor” dhe “Shërbimet e kujdesit publik”;
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me programet buxhetore : “Mbrojtja sociale” dhe “Shanset e barabarta”;
- Zëri “Shpenzime buxhetore për personelin” për të gjithë buxhetin qendror.

Për të përcaktuar buxhetin për fëmijë në rajonin e Kukësit, krahas informacionit mbi fondet buxhetore të buxhetit qendror dhe vendor, përlllogaritet numri total i popullsisë së Qarkut Kukës dhe rretheve Kukës, Has dhe Tropoje si dhe numri i familjeve dhe i fëmijëve. Me anë të

përlllogaritjes së këtyre treguesve, pasi vendosen koeficientet e duhur, përlllogaritet buxheti për çdo fëmijë.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten të dhëna demografike në qarkun Kukës për vitin 2012:

Tabela 1 : Numri i fëmijëve dhe raporti me numrin total të popullsisë dhe familjet për vitin 2012 për Qarkun Kukës.

Burimi: Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

	Nr.fëmijëve	Nr.popullsisë	Nr.fëmijëve/Nr.popullsisë (%)	Nr.familjeve	Nr.fëmijëve/Nr.familjeve
A	B	C	d=b/c	E	f=b/e
Qarku Kukës	33922	107911	31.44 %	26461	128.19%
Kukës	18802	58964	31.89 %	13471	139.57%
Has	7096	20966	33.85 %	4896	144.93%
Tropoje	8024	27981	28.68 %	8094	99.13%

2. Buxheti qendror

2.1 a) Shpenzimet buxhetore qendrore për zhvillim dhe arsim

Shpenzimet buxhetore për arsimin parauniversitar nga pushteti qendror, janë fonde nga të cilat fëmijët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi përfshin shpenzime korrente dhe investime në institucione ku përfitues janë fëmijët.

Në tabelë pasqyrohen shpenzimet korrente dhe investimet për fëmijët në vitin 2012:

Tabela 2: Buxheti për vitin 2012 për arsimin e detyruar për Rrethin Kukës, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Kukës), DAR kukës,

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve në shkolla	Buxheti për fëmijë (000 lekë)
A	b	C	d=b+c	E	f=d/e
Kukës Rreth	430252	21857	452109	16 612	27.21

Tabela 3: Buxheti për vitin 2012 për arsimin e Mesem për Rrethin Kukës, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Kukës), DAR kukës,

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve në shkolla	Buxheti për fëmijë (000 lekë)
A	b	C	d=b+c	E	f=d/e
Kukës Rreth	77319	12659	89978	2667	33.73

2.1 b) Shpenzimet buxhetore qendrore për sektorin e shëndetësisë

Shpenzimet në sektorin e shëndetësisë shkojnë për të gjithë popullsinë duke përdorur llogjikën se përdorimi i tyre është i njëjtë për të gjitha shtresat e popullsisë, të fëmijët nga ky fond shkon siç është raporti i numrit të fëmijëve ndaj numrit të përgjithshëm të popullsisë.

Tabela 4: Buxheti qendror për vitin 2012 për shëndetësinë në Rrethin Kukës, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Kukës), Dhjetor 2012.

	Shpenzi me korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve/ Nr.popullsisë(%)	Buxheti për fëmijë total (lekë)	Nr.i fëmijëve	Buxheti për çdo fëmijë (000 lekë)
A	B	C	d=b+c	e	f=d*e	G	i=f/g
Rethi Kukës	214003	6674	220677	32 %	70616	18802	37.558

2.1 c) Shpenzimet buxhetore vendore për shpenzime personeli

Tabela 5: Buxheti vendor për fëmijë për shpenzime personeli për vitin 2012 në rrethin Kukës, (në 000 lekë).

Burimi: Vjetari Statistikor i Drejtorisë së Statistikës Kukës, Janar 2013.

Vitet	Shpenzime personeli (000 lekë)	Nr. i punonjësve buxhetorë	Nr. i familjeve	Nr. i personave në këto familje	Nr. i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (000 lekë)	Buxheti për çdo fëmijë (000 lekë)
A	b	C	d=c/1.5	e=d*4.2	f= d*2.2	g= (b/e)*f	h=g/f
2012	214916	604	402	1688	884	1 125 550	127.319

Tabela 6: Fonde te akorduara nga MPCSSHB per politikat sociale në qarkun kukës

Burimi: DRSHSSH Kukës

Vitet	Ndihma ekonomike (ne 000 leke)	Nr i familjeve perfituese	Numri i personave ne keto familje	Numri i femijeve ne keto familje	Buxheti per femijet (ne 000 leke	Buxheti per nje femijet(ne 000 leke
a	b	c	d=c*4.2	e=c*2.2	f=(b/d)*e	g=b/f
2009	530,800	11,360	47,712	24,992	278.038	11.12
2010	571,000	12,718	53,416	27,980	299.097	10.68
2011	584,500	12,269	51,530	26,992	306.167	11.34
2012	579.811	12,555	52.731	27.621	303.711	11.00

Tabela7: Buxheti dhe numri i fëmijëve që kanë frekuentuar, për vitet 2010-2011-2012, qëndrën e Shërbimeve sociale në Bashkinë Kukës.

Burimi: Bashkia Kukës

Vitet	Qendra sociale Bashkia Kukës		
	Nr. Fëmijëve	Fonde	Buxheti për fëmijë (000 / lekë)
a	b	c	d = c / b
2010	12	2.013	167.7
2011	12	2.013	167.7

2012	13	2.013	154.8
------	----	-------	-------

Tabela 8: Fonde te akorduara nga MPCSSHB per politikat sociale në qarkun kukes sipas njësive vendore per vitin 2012;

Burimi: DRSHSSH Kukës

<i>Emertimi I Njesise</i>	<i>Familje Gjithsej viti 2012</i>	<i>Fondi/000L</i>	<i>Nr.Familjeve Gjithsej NE</i>	<i>% Ndaj Totalit</i>
Bashkia Kukës	4222	95185	2081	0.49
Komuna Malzi	979	23150	490	0.50
Komuna Bicaj	1721	29800	835	0.49
Komuna Ujmisht	623	15865	356	0.57
Komuna Terthore	721	19860	437	0.61
Komuna Shtiqen	871	22452	468	0.54
Komuna Zapod	850	19190	393	0.46
Komuna Shishtavec	1078	21486	516	0.48
Komuna Topojan	560	16078	381	0.68
Komuna Bushtrice	383	15105	304	0.79
Komuna Surroj	402	12350	322	0.80
Komuna Arren	165	5640	99	0.60
Komuna Kolsh	310	9497	205	0.66
Komuna Kalise	194	9481	172	0.89
Komuna Grykeçaje	324	8300	244	0.75
Total Rrethi Kukes	13403	323439	7303	0.54
Bashkia Krumë	1561	35290	702	0.45
Komuna Golaj	2048	38045	726	0.35
Komuna Fajza	949	21512	494	0.52
Komuna Gjinaj	328	14210	287	0.88
Total Rrethi Has	4886	109057	2209	0.45
Bashkia B.Curri zv	1929	35700	701	0.36
Komuna Bytyç zv	563	15589	286	0.51
Komuna Lekbibaj	589	15258	332	0.56
Komuna Fierze	750	12351	257	0.34
Komuna Margegaj	895	14839	327	0.37
Komuna Bujan	891	13310	286	0.32
Komuna Llugaj	768	9733	225	0.29
Komuna Tropoje F	1754	30535	629	0.36
Total Rrethi Tropoje	8139	147315	3043	0.37
Total Qarku Kukes	26428	579811	12,555	0.48

Zonat me % më të larte të familjeve që trjatohen me ndihme ekonomike në rajon janë komunat Kalisë 89% Gjinaj 88% Bushtricë 79% Grykë-Çajë 75% ,Topojan 68% Kolsh 66%, Gjinaj të rrehit Has, Fierzë, Bytyç e Lekbibaj të rrehit Tropojë etj.

Qytetet vazhdojnë të popullohen me banorë që zbresin nga fshatrat përreth.

Ekonomia bazohet kryesisht në sektorin e bujqësisë që prodhon vetëm për mbijetesë ekonomike.


Nga studimi i nivelit të jetesës (LSMS 2002)⁴ rezulton se 86 % e fëmijëve që nuk ndjekin arsimin e detyruar në rajonin e Kukësit i përkasin zonave të thella malore dhe 61 % prej tyre familjeve të skemës së ndihmës ekonomike.

Tabela 8: Fondet buxhetore të alokuara nga MPCSSH B për politikat sociale per vitin 2012, Qarku Kukës.

Burimi: Shërbimi Social shtetëror, zyra rajonale Kukës.

	Ndihma ekonomike (000 lekë)	Nr.familjev e përfituese	Nr.personave në këto familje	Nr.fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijë në total (000 lekë)	Buxheti për çdo fëmijë(000 lekë)
a	b	C	d=c*4.2	e=c*2.2	f=(b/d)*e	g=f/e
Qarku Kukës	579.811	12555	52731	27 621	303.711	10.996
Kukës	323.439	7303	30673	16 067	169420	10.545
Has	109.057	2209	9278	4860	57125	11.755
Tropoje	147.315	3043	12781	6695	77165	11.526

Grafiku 1: Numri familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike dhe fëmijet që jetojnë në familje me ndihme ekonomike për vitet 2010-2012 në qarkun Kukës



Si në çdo rast, vlerësimi i implementimit të politikave, duket më qartë në pjesën e fondeve që alokon çdo institucion në buxhetin e tij për zbatimin e tyre prandaj për shkakë të mungesës së dëshirës dhe

⁴ Studimi i nivelit të jetesës , (LSMS 2002)

zvarritjes, mungesës së transparencës nga ana e drejtuesve lokal, përfshirë këtu edhe shkaqe ligjore apo strukturore, ka qenë e vështirë të nxirren dhe llogariten fondet buxhetore që institucionet e vartësisë vertikale dhe pushteti vendor kanë përdorur për të mbështetur politikën e tyre për mbrojtjen e fëmijëve. Mungon llogari dhënia brenda institucioneve.

Nuk kemi gjetur ndonjë formulë dhe mbështetje ligjore për detajimin e buxheteve të njësive vendore që përdoren për përmirësimin e të drejtave të fëmijëve. Institucionet marrin grante të kushtëzuara të cilat sipas punonjësve të njësive vendore kushtëzohen për fëmijët.

Nga vëzhgimet e bëra në terren pushteti vendor në përgjithësi nuk ka planifikuar fonde me synime të veçanta për fëmijët por vetëm për të ofruar shërbimet kryesore për ndihmën ekonomike, mbulimin e shpenzimeve për riparime dhe shpenzime të tjera kancelarike për arsimin, shëndetësinë, kulturën etj.

Përveç bashkive në asnjë komunë nuk ka kopshte me ushqim apo çerdhe për fëmijët.

Nuk ka një database për projektet që zbatohen për fëmijët nga shoqatat lokale, kombëtare, apo institucione të ndryshme. Si i tillë qarku nuk është në gjendje të monitorojë nivelin e zbatimit të politikave.

Buxhetimi me pjesëmarrje

Buxhetimi me pjesëmarrje të gjerë është një mekanizëm, i cili u mundëson qytetarëve që të marrin pjesë në vendimmarrje në menaxhimin e të gjitha burimeve, ose të një pjese aktive të financave publike të pushtetit lokal. Buxhetimi me pjesëmarrje ka për qëllim ngritjen e transparencës, përgjegjësinë dhe përfshirjen sociale në qeverisje.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një trajtim i ri që sjell komunitetet lokale më afër procesit të vendimmarrjes lidhur me buxhetin publik. Kjo praktikë e re financiare ka potencialin që të rrisë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve përsa i përket vendimmarrjes rreth buxhetit si dhe për të ndihmuar qeverinë për të përmirësuar transparencën, efikasitetin, dhe përgjegjësinë mbi buxhetin.⁵

Nje problem qe eshte hasur ne te gjitha njesite vendore te qarkut kukes eshte se asnje nga njesite vendore nuk grumbullon te ardhura te mjaftueshme per te patur mundesi qe te planifikoje fonde te veçanta per tua ardhur ne ndihme grupeve vulnerabel.

Gjetjet dhe konkluzionet

- **Buxhetimi me pjesëmarrje** është i detyruar me ligj, asnje nga njesite e qeverisjes vendore ne qarkun kuukes nuk e ka ndërmarrë këtë nismë.
- Në këto njësi vendore nuk ka një buxhet specifik per perfshirjen e femijeve dhe ne aktivitetet.
- Vetem ne bashkine kukes financohet me fondet e bashkise qendra e sherbimeve sociale.
- Edhe per gjate ketij viti buxhetor nuk shohim ndonje perspektive qe të kemi ndonje buxhet të veçante për femijet, por situata vjen dhe keqësohet me shume kur diskutohet për ndarjen e re territoriale dhe njesite që janë aktualisht nuk e shohin te sigurve ekzistencen e tyre.

⁵ Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri (2006), Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Rekomandime

- Duke qenë se fëmijet zënë më shume se 30% te numrit te banoreve në çdo njësi vendore duhet të mendojme më shumë për të patur një buxhet specifik për fëmijet, dhe ky buxhet mos të ngelet vetem ne kuader të granteve që delegon pushteti qendror.
- Shperndaja e buxhetit duhet të bëhet mbi nevojat dhe prioritet e fëmijeve duke u bazuar në analiza dhe raporte që nxjerrin në pah situatën e fëmijeve në çdo njesi vendore.
- Buxheti me fokus fëmijet duhet të jetë prioritet i çdo njësie vendore, si në financim për arsim, shendetesi, dhe për fëmijet me aftësi të kufizuar.

· **Bibliografia**

- Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri (2006), Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore .
- Ligji vjetor i buxhetit nr. 10355 datë 2.12.2010.
- Ligji nr.8379 datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9355 datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, viti 2005, faqe 829.
- Ligji nr. 3766 datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor” (i ndryshuar), botuar në Fletoren Zyrtare nr. 16, viti 1963, Faqe 312.
- OBSH (2001), Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.
- Programi buxhetor “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe ai profesional”.
- Programi buxhetor “Shërbimet e kujdesit parësor”, “Shërbimet e kujdesit publik”.
- Program buxhetor i MPCSShB “Mbrojtja sociale”, “Shanset e barabarta”.
- Projekt buxheti PBA 2011- 2013, Ministria e Financës, Drejtoria e përgjithshme e buxhetit.
- Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri Unicef.
- Relacion mbi buxhetin faktik 2011, Ministria e Financave, Drejtoria e përgjithshme e buxhetit.